

BIBLIOTEKA

E

814-1

9158

SHKËRTI

GJIROKASTER

Ndoc
Gjetja

ÇASTE



poezi

8JH-1
8158

Ndoc Gjetja

ÇASTE

SKRJA THOMA



BIJTE
E NIFREVE
TO NIRE

poezi

SHTËPIA BOTUESE
NAIM FRASHËRI

1978
8728

Ndoc Gjetja

CASTE
Redaktore

ISKRA THOMA

poezi

SHTRIPIA BOTUESE
NAIM FRASHËRI

PO TË ISHA VETËM

Me kënaqësi të madhe kam lexuar dhe u interesova shumë për
librin tuaj të parë, që është një vepër e rëndësishme për
historinë e popullit tonë. Është një libër i vlerueshëm
që tregon për jetën dhe kulturën e atyre kohëve.

Libri është i shkëlqyer dhe i vlerueshëm. Është një
kontribut i rëndësishëm për historinë dhe kulturën
tonë. Është një libër i vlerueshëm që tregon
për jetën dhe kulturën e atyre kohëve.

**BIJTË
E NJERËZVE
TË MIRË**

PO TË ISHA VETËM

Më është bërë zakon dhe s'mund të rri një ditë pa e bërë një shetitje atje te sheshi në qendër, që të shoh fytyrat e shokëve e miqve të mi dhe fytyrat e njerëzve që s'ua di as emrin.

Dikush ecën me nxitim, dikush ecën mengadalë, dikush ecën i shoqëruar e dikush ecën vetëm, njëri ma bën me dorë që nga larg pa u ndalur, tjetri më kërkon cigaren për të ndezur të veten.

Dhe duke lecur gjendem në mes turmës së
 dëndur,
 në mes bijve dhe bijave të njeriut të mirë,
 dhe qenia ime bëhet si një instrument i
 ndjeshëm,
 të cilit vetë gëzimi me duart e tij i bie.

Këtu s'të kujtohet fare dita kur ke lindur
 dhe s'mund ta marrësh me mend se njeriu një
 ditë vdes.
 Këtu janë të gjitha moshat, këtu më duket
 vetja i pamoshë,
 veç po të isha vetëm, do të isha dyzet vjeç.

Porsa fillon të vijë mëngjesi, mërmë
 në qiell shuhen të gjithë yjet,
 se tashmë janë zgjuar njerëzit,
 i kanë hapur sytë e tyre. —
 dhe prej tyre buron dita. —

Fjala e mirë dhe ndëjta me njeriun
 e kanë brenda farmacinë.

Mbrëmë fjeta në hotel me një njeri të
panjohur.
Kollitej gjithë natën, rrugës ishte ftohur.
— Më fal, — thoshte, — po të le pa gjumë!
— Më fal, — i thosha, — që nuk po të hyj
në punë!
— Të lutem, — thoshte, — ç'të kërkoj nga ti
më tepër?
Fjala e mirë dhe ndejtja me njeriun
e kanë brenda farmacinë.

U grinda me një shokun tim të ngushtë
për ca imtësira pa rëndësi shoqërore,
sa herë ndodheshim ballë për ballë në rrugë,
mjaftoheshim vetëm me një tundje koke.

Shtatë ditë pa i folur njëri-tjetrit,
shtatë mëngjeze pa atë kafënë që e pinim
bashkë,
rrethin e gëzimit të krijuar me njerëzit
e ndjeja të ngushtuar pak.

Dhe një zbrazëti e shurdhër m'u krijua
brenda vetes,
që s'mund ta mbushja me shokë të rinj,
se kjo zemra s'qenka si autobuzi i unazës,
ku zbret njëri e tjetri ulet në vend të tij.

Pas pesëmbëdhjetë ditëve
kur u kthyem nga plazhi,
unë pashë se te pragu i derës
kishin mbirë ca fije bari.
Sa shumë e paske ndjerë, moj shtëpi,
mungesën e njeriut!

trëtin e gëzimit të krijuar me njerëzit
e ndjeja të ngushtuar pak.

Dhe një shpazëti e shurdhër m'u krijua
përnda vetes.

dë s'mund ta mposhta me shokë të rinj,
se kjo zemra s'denka si autobus i unazës,
ku shpët njeri e tjetri ulët në vend të tij.

NJË NATË

Binte shi dhe frynte erë,
ish një natë e errët pus.
Ecja fushës duke shkelur
nëpër baltë udhë pa udhë.

Çadrën era ma rrëmbeu
dhe ma flakur' di ku tej
O qiell, ndize një vetëtimë
bëmë dritë sa ta gjej!

Ec një hap e mate këmbën,
të mos biesh nëpër gropa
Mbylla sytë e pashë zemrën
pakëz dritë prej saj moram

ËNË NATË

Përmes natës që kullonte
 ngricë e terr e pika shiu,
 befas veshi më dëgjo
 si në ëndërr zë njeriu.

Sa u gëzova dhe i thirra,
 që të vinte drejt meje:
 — Oheeeej — thosh në terrin,
 ma çonte zërin si një urreze.

Ai atje dhe unë këtu,
 njëri-tjetrin pa e parë,
 për të mos ecur kuturu,
 ndiznim thirrjet si pishtarë.

Unë s'e dija se si quhej,
ai s'e dinte timin emër.
Njëra thirrje porsa shuhej,
ndiznim prapë thirrjen tjetër.

ORTEKU

Ndanë udhës së makinës që dredhonte
nëpër bjeshkët e Tropojës
sajova ashtu kot një top dëbore
sa grushti i foshnjës.

Pastaj e hodha në luginë
dhe topi mori rrokullimën.
Ndërkohë shoferi te makina
kontrollonte benzinën.

Kur ç'të shoh! Hata e zezë!
Ai top dëbore ishte rritur,
ishte bërë sa makina
dhe thyente lisat duke zbritur.

I rashë ballit me pëllëmbë
dhe zura veshët me dorë
mos t'i dëgjoja duke rënë
ata lisa në dëborë.

Po sikur ai top dëborë,
që e hodha ashtu kot,
të kishte qenë një fjalë e keqe,
e pamenduar për një shok?

is shkela syrin tim të gjallë,
Se si më erdhi... dhe syrit të delpitë
dhe prapë trokita tri herë me rashë,
Dhe prita të pragu, por dera s'u hap,

«SYRI MAGJIK»

Kohët e fundit shoku im në derë
ka vënë një «sy magjik» prej qelqi.
Kur ishte jashtë, thonë, e ka blerë,
në skajin verior të kontinentit.

Me atë «sy» ai shikon nga brenda
fytyrën e atij që troket nga jashtë.
— Eh, ç'i paska pjellë mendja
shpikësve modern — me vete thashë.

Dhe prita te pragu, por dera s'u hap,
dhe prapë trokita tri herë me radhë.
Se si më erdhi... dhe syrit të qelqtë
ia shkela syrin tim të gjallë.

2000000000

NJE DITE

Sikur të mendoja vetëm një çast,
që shoku fytyrën ma shihte nga brenda,
do të isha rrëzuar aty në prag,
nga keqardhja, trishtimi e dhembja.

imitova zogjtë, imitova kalshët,
përplasas në ajër shuplakat,
pastaj e tunda një lodër plastike
me gurë të vegjël brenda.
Kështu të gjitha këto papritur,
këthen të bëra të shkurtër përdorimi,
u zhvilluan në...



48383

NJË DITË

Një ditë në shtëpi, u bëra padashur,
aktor amator i teatrit të kukullave,
për të qetësuar fëmijën
që qante me kuje;
imitova zogjtë, imitova kafshët,
përplasa në ajër shuplakat,
pastaj e tunda një lodër plastike
me gurë të vegjël brenda.
Por të gjitha këto papritur,
patën një afat të shkurtër përdorimi,
u zhvlerësuan fare,
se erdhi... e ëma.

NJË FËMIJE

Ti përse kërkon kështu vogëlush
të më shqitesh prej krahut,
thërret e bërtet e godet më grusht,
sikur ke frikë nga fytyra e xhaxhit.

Vërtet xhaxhi ka fytyrë të ashpër
dhe s'mund ta kishte ai të butë,
se tiparet ia gdhendën ngjarjet,
kur kundër njeriut bëhej luftë.

Ti ke frikë të ma prekësh fytyrën
plot me gjëmbaçë qimësh burrërore,
sepse në të janë shkruar detyrat,
që kreve në luftën e ashpër klasore.

M'i thuaj ca fjalë, m'i belbëzo ca rrokje,
 m'i derdh të qeshurat e tua në zemër!
 Vetëm ato ma zbresin moshën,
 më bëhen mbështetje duke ecur.

Vërtet xhaxhi ka lypur të ashpër
 dhe s'mund ta kishin ai të butë,
 se t'parat ia gdhendën ngjarjet,
 kur kundër tijnit bëhët luftë.

Ti ke frikë të ma prekësh lypurin
 plot me gjëmbaqë dimësh burrëtonë,
 sepse në të jamë shkruar detyrtat,
 që kërva në luftën e ashpër klasorë.

NDODHI E VOGËL

Policit të trafikut një ditë,
i doli përpara një fëmijë.
— Dua bilbilin... — i thoshin sytë
dhe bënte me buzë ashtu «Fy-fy».

Policit nga brenda një zë i tha:
— Shoku polic mos bëj shaka!
Bilbilin tënd s'është fare serioze,
ta marrë të lozë me të një foshnje.

Me këtë bilbil drejton trafikun,
shmang rrëmujën edhe rrezikun,
pa këtë bilbil, këtu në shesh,
aksidente do ndodhnin shpesh.

E di, e di, — tha me vete polici, —
rëndësinë e madhe që ka bilbili,
po si t'ia bëj me këtë fëmijë, —
që bën me buzë ashtu «Fy-fy»?

Meqenëse veten po e ndjente ngusht
iu desh bilbilin ta fshehë në grusht.
Por kur fëmija filloi të qajë,
brenda policit u zgjua babai.

Dhe befas ndjeu t'i hapet grushti
bilbilin e nxori dhe buza i qeshi:
— Le t'i bjerë një herë vogëlushi
vetëm një herë se s'bëhet qameti!

TELEKRONIKAT

Ky fëmijë, me fytyrë pranvere,
Ku ka shikimin ka dhe zemrën.
Po mos ia jepja bilbilin një herë,
unë do të bëja aksident me veten.

Ekrani më duket
si një sy i madh
i ngurdhulluar në caste tmerr.

Dhe më duket sikur
do të pëlqasë nga casti në cast
syri i dëlqet nga pesha e dhimbjes.

Dhe do të kish pëlqitur
po mos të detësohej
nga ky program me këngë fëmijësh.

TELEKRONIKAT

Telekronikat e darkës
kullojnë gjak
prej plagëve të hapura të planetit.

Ekрани më duket
si një sy i madh
i zgurdulluar në çaste tmerri.

Dhe më duket sikur
do të pëlçasë nga çasti në çast
syri i qelqtë nga pesha e dhimbjes.

Dhe do të kish pëlçitur
po mos të qetësohej
nga ky program me këngë fëmijësh.

KRONIKË

Atë ditë nëna ma nxori djepin në oborr të
shtëpisë,
nën hijen e manit bëra një gjumë të ëmbël
fëmije,
tre pëllumba të bardhë erdhën me krahë të
butë ëndërre,
më morën e më çuan, s'di ku, nëpër ca hapësira
drite.

Kur, ja, në qiell u shfaqën aeroplanët e
Adolf Hitlerit
dhe piloti ma vuri në shënjestër foshnjërinë e
njomë,
por plumbat nuk mundën të ma kafshojnë
djepin,
kafshuan manin dhe oborrin tonë.

Dhe nga mani ranë tri viktime të copëtuara
gjethesh,
që Lufta e Dytë Botërore pranë djepit tim i
shtriu.

Unë u zgjova dhe duart e njoma i tunda
drejt nënës,
si dy flamuj që thoshin se do të fitojë njeriu.

Kur, ja, në diell u shfaqën aeroplanët e
Adoll Hitlerit
dhe piloti ma vuri në shënjestër loshnjërinë e
njomë,
por plumbat nuk mundën të ma kalshojnë
djepin,
kalshuan manin dhe oborrin tonë.

NGJARJA E PARË

Në dyshemenë e drunjtë të kullës sonë të vjetër,
atë ditë fillova të hedh hapat e parë,
duke u mbështetur në fillim tek dorat e nënës
e pastaj vetëm te shikimi i saj.

Nga shkallët zbrita dhe dola gjer te udha,
ndërsa nëna e hoqi kokën nga dritarja,
kur befas u rrëzova e rashë në pluhur
dhe më kapi frika dhe qava e qava.

Sepse në udhën e shkretë e pa njeri,
po ndodhte një ngjarje tragjike e rrallë:
vraponte e vraponte duke lehur një qen i zi,
i cili po ndiqte një mace të bardhë.

Oh, macja ish e vogël, oh, qeni ish i madh!
 Dhe qeni ish i shpejtë dhe macja jo më pak.
 Dhe macja që nga udha kapërceu një gardh,
 pastaj u ngjit atje në lirin tonë plak.

Atëherë pafuqia e qenit u kthye veç në lehje,
 atëherë e qara ime u kthye në buzëqeshje.
 Që atëherë e gjer më sot që u bëra dyzet vjeç,
 më bukur se atë ditë s'kam mundur kurrë të
 qesh.

KUR LUANIM

Të gjithë moshatarët e fëminisë
unë i mundja
kur luanim lojën «Kush është më i forti».
Dhe ëndërroja të bëhesha Gjeto Basho
Muja
ose Gjergj Elez Alia,
që e mundi Balozin.

Ndonjë fëmijë i prapë
në qoftë se shihej duke qarë në udhë,
askush s'e pyeste «Pse qan?»
sepse dihej shkaku:
e kish pësuar nga unë.

Të gjithë moshatarët zevzekë që shanin,
 dhe ata që fyenin
 me fjalë të rënda shokët,
 unë i thërrisja në «fushë të mejdanit»,
 se ishin «antagonistët» e eposit tim të
 vogël.

Por tek forca qëndronte dobësia ime,
 se ajo më pengonte që të mësoja
 dhëpërinë e të dobëtisë,
 i cili më shfaqej me sjellje të hijshme,
 si një Baloz i bardhë
 me fjalë të mira shoku.

NË MOBILERI A KËNGA

Këta damarë të dredhur druri
dhe këto nyje të kombinuara
në rimeson tërë llustër,
unë s'kam zemër që t'i shoh grua,
as të më duken të bukur.

Se tek çdo nyje rafti shoh
një degë të prerë peme,
e cila më zgjatet në kujtesë
duke dëshiruar gjethët, zogun,
fëshfërimat në pranverë.

Por me qenë se rafti i duhet
çdo njeriu dhe çdo shtëpie,
për të qenë i qetë me veten,
le të marrim atë më tutje,
që nuk paska fare nyje!

KËNGA IRIJERI

Dëgjoj një vajzë që po këndon
një melodi me «tra-la-la»
te dhoma e saj pa mikrofonë
pa drita skenash të mëdha.

Ajo këngë është e panjohur
Po cili është kompozitori?
Vajza vetë e ka krijuar,
autor është veç kraharori.

Ajo është një këngë e thjeshtë
pa aranzhim e fjalë poeti,
nga larg vjen si fllad i lehtë
më përkëdhel si valë deti.

Mbi mua bien «tra-la-la»-të,
si mbi gjeth ca pika shiu,
muzikë më të bukur në botë s'ka
se sa zëri i njeriut.

Die für Kinder
Kostantin Vogel
zu den
in der
zu sein

Kan vit
në këtë
këtë këngë
në këtë

MOTRËS

Lotin e burrit mezi e mbaj
duke përcjellur motrën nuse.
Te pragu i derës dora e saj
si një pëllumb më ulet mbi supe.

Dhe më kujtohet Gjeraqina,
Kostandini i Vogëlith mbi kalë,
s'do të ish çudi, si në baladë,
të plasim si qelqi nga ky mall.

Kaq vite motër rrojtëm bashkë,
nën këtë çati shtëpie të thjeshtë,
ku të kanë gëzuar dhe dy metër basmë
të një fustani të prerë për festë.

Tani po ikën... Ti falja vëllait
ndonjë shikim me sy të mvrejtur,
ndonjë ndalesë, ndonjë shuplakë,
ndonjë fjalë që vret në zemër.

Dhe falma pyetjen: «Ku ishe mbrëmë?»;
që ndonjëherë ta bëri vëllai,
se kisha harruar që ishe një pemë,
së cilës s'i duhet breshëri në maj.

DRINI

Nga dritarja shoh Drinin,
i cili kalon fare pranë mureve
të shtëpisë së prindëve të mi në Lezhë.
Dhe më kujtohet koha kur ai
rrihte brigjet me shkulma,
në dimër, në pranverë, në vjeshtë.

Tani një rrëkajë të ngathët uji,
duke e hequr zvarrë-zvarrë,
mezi arrin ta çojë tek deti.
Dhe më vjen keq për të,
si për një njeri që e dua,
kur shoh se është dobësuar nga shëndeti.

Po ç'them kështu?

Ai do të fyhej po ta dinte,
që po e mëshiroj këtu në heshtje,
se ai s'është dobësuar si harrakati,
duke rendur pas qejfeve.

Drini im i dashur,
Drini im i mirë,
mbështetet i rri si altruist
mbi ferrobetonin e digës
dhe veten e hedh tri herë me radhë
mbi katër turbina
në emër të dritës.

BUZËQESHJA

Në fytyrë të ka rënë një hije shefi
ashtu siç bie muzgu në natyrë.
Ç'pate që t'u bllokua rubineti
nga i cili të rridhte një thjeshtësi e mirë?

Trak, ti e hap dhe e mbyll buzëqeshjen
sikur të ishin buzët një kuti,
dikur, vëlla, na çaje veshët
me «Ha-ha-ha» dhe «Hi-hi-hi».

Tani të duhet një buzëqeshje e shkurtë,
se buzëqeshja e gjatë të sjell rreziqe,
ke frikë se mos të bën një «kuadër të butë»,
të bëhet pengesë në udhën për ngjitje.

GJYSHI

Në vitin kur u shpik atomi
dhe bëheshin hapa të mëdhenj në shkencë,
gjyshi im në Bjeshkët e Namuna
shtegëtonte pas kopesë.

Tërrrrr — bërtiste atje në pyjet
kundruall maleve të tij pellazgë,
dhe një shkop tërë gunga e nyje
e tundte në ajër si shpatë.

Me atë klithmë shtynte tufën,
te shtegu i ngushtë i bjeshkës,
dhe trembte ujqërit, hijet,
shtrigat dhe vetminë e vetes.

Dhe gjithkund i shkonte prapa
roja e bardhë mitike e fisit,
që ishte më e sigurtë se garda
e presidentit dhe e kryeministrit.

Dhentë kullosnin. Ai rrinte
mbi një fron të ashpër shkëmbi.
— Ulu dhe ti! — i thosh dhe ulej
si një pazh i bindur qeni.

Si balerinë të vegjël kërcenin
qingjat në bar të njomë,
më tej luftonin për karrierë
dy gjeneralë-desh përçorë.

Dhe sa hije i kishte ndejtja
mbi atë fron shkëmbi të thinjur,
të cilin ia zinte vetëm
dëbora e bardhë në dimër.

Sa hije i kishte ai skeptër thane,
ai shkop i gdhendur me brisk,
ajo qeleshe e rrëzuar mënjanë,
ai gjoks-kala, ai ballë fisnik!

Sa hije i kishin ato mustaqe
të derdhura, të zeza, të gjata,
kur i tundte si dy medalje
në kuvende, festa e dasma.

E kishte një botë të lirë njeriu,
ku rronin bashkë dashuria e dhembja,
por askush me një çelës kopil
nuk mund t'i hynte brenda.

Nga zemra i dilte si rrëmeti
një ushtri e stërmadhe mërie,
që s'mund t'ia thyente as mbreti
me të gjithë ushtarët dhe hafijet.

E kishte një vulë të rëndë grushti.
me të cilën i zhvlerësonte fare
të gjitha vendimet e zyrave,
kur ngjiteshin lart në male.

Dhe kur vdiq prej plumbave, plagëve,
veç mustaqet, gjyshi i varfër,
i mori me vete si dy medalje
të burrërisë së pastër.

KUR SHIKOJA NJERËZIT NË DITËT E PLAZHIT

Në ditët e plazhit shoh se si njerëzit lëshohen
krejt natyrshëm në krahët e lira të
shkujdesjes,
lëvizjet e tyre s'kanë se si mos të ndikohen
nga gjerësia e detit dhe lirshmëria e rërës.

Këtu dhe filozofi, të cilit koka
i zien nga studimet ditë e natë,
nuk mund të mos harrohet pas gjërave të
vogla,
që do ta ndihmojnë për të zbuluar të
mëdhatë.

Këtu zhvlerësohet fare pamja e seriozit
dhe ka lezet të shohësh ndonjë burokrat të
zyrës,

duke mbledhur bregut guaska të bukura,
ose duke lojtur me një top fëmijësh.

Nga ujërat dalin nimfat gra dhe sirenat
vajza
dhe djemtë dhe burrat me stërkala uji te
gjoksi,
unë rri dhe i lexoj si në një libër të hapur
linjat lirike të poezisë së tyre trupore.

Dhe të gjithë janë të bukur. Dhe asnjëri dhe
asnjëra
s'është fare më e bukur se shoqja a shoku.
Unë i shoh dhe kam përshtypjen se këto
pulëbardha,
sapo kanë dalë nga deti i tyre i gjoksit.

POLITIKA
E TUNDJES
SË BRIRËVE

NË DOGANË

Nëpunësi i doganës
duke kontrolluar në çantën time të plaçkave
gjete një distinktiv të Skënderbeut
dhe para tij
sytë i shqeu.

Dhe e mbylli në sirtarin e tij të zyrës
stërgjyshin tim,
të lavdishmin,
trimin,
si një material propagandistik,
i cili nuk duhet
të kalojë kufirin.

— Merri! — tha
dhe i mora plaçkat
të bëra rrëmujë.

— Kaloni! — tha,
dhe ne kaluam
në dhë të huaj.

Vetura hante shiritin e gjatë të udhës
dhe skapamentoja
shkëndija villote.

Nëpër gjakun tim të trazuar
treqind Skënderbej
lëviznin.

NË PALLATIN E PROGRESIT TEKNIK

Të gjitha shpikjet,
sa bukur i kanë rreshtuar,
këtu në pallatin e madh të Progresit Teknik,
që nga vegla e parë prej guri të latuar
deri te aeroplani supersonik!

Vërtetë sa shumë ka përparuar bota!
Ja, shilarsi me korrent i parkut të lojrave
dhe pak më tej elektroshoku i hetuesisë,
dhe byzylyku i gruas,
dhe pranga e qelisë,
dhe tanku i dhunës,
dhe karroca e fëmijës,
dhe lapësi i shkollarit,
dhe kamzhiku i policit,

dhe ekspresi i kafesë,
 dhe bomba me sahat,
 dhe karamanjolla e Luigjve,
 dhe makina e shkrimit...

Të panumërta qenkan
 gjithë këto makina e vegla,
 me vlera të shumëllojshme përdorimi.
 Vërtet, sa shumë ka përparuar shkenca!
 Te këmbët e saj
 është ulur mjerimi.

BISEDE ME MERIN

Njeriu lind e rritet dhe një ditë prej ditëve
i thotë një vajzë «Të dua» dhe martohen
bashkë.

Ai që do të vijë nga bashkëfjetja e tyre
do të rreshtohet nesër në njerën klasë.

Po njeriu nuk mund ta dijë pa lindur
përkatësinë klasore të prindërve të vet.
Unë vetë, për shembull, mund të kisha pasur
prindër
një zonjë princeshë ose zotin president.

Por ja, unë pata rastësinë e mirë, të jem filiz
i një trangu fshatarësh malësorë të varfër.

— Po a mund të jetë ky një subjekt i
krenarisë? —
më pyet kjo Meri, bijë e milionerit Kramër.

BIBLIOTEKË E MERIN

T'ju them të drejtën, zonjushëza e bukur
Meri,
për mua kjo s'është një pyetje e vështirë,
sepse unë rrjedh nga prindër që vetëm qenin
në oborr të shtëpisë e lidhnin me zinxhirë.

NJË GAZETARI BORGJEZ

Kam hapur e po lexoj gazetën tuaj të ditës
se desha të dëgjoj ç'thonë krajlrat për luftën
dhe paqen.

Ky lajmi këtu na thënka: «Ujkun e hëngri
qëngji»

Ky tjetri thënka prapë: «Miu e hëngri
macen».

Dhe kjo mizëri e gërmave e ngjeshur në
kolona
gumëzhin pandërprerje nëpër fushë të letrës
sikur ka ardhur nga gjaku e pirgjet me
kufoma
nga plagët e hapura në kurrize shtetesh.

Dhe sa bukur me fraza e paskeni endur velin
pas të cilit fshihet fytyra e zezë e krimit!

Por unë e shoh atë...

Sepse unë zotëroj sekretin
mënyrën time të leximit.

Dhe ja se si lexoj:

të gjitha frazave e fjalëve
ua marr kuptimin e ua kthej së prapthi,
kështu bëj edhe me fotot e qeshura të
politikanëve
që nga më i thjeshti deri te Regani.

Dhe duke lexuar kështu, unë zbuloj enigmën
anën e prapme të asaj që gazeta kurrë s'e
thotë:

politikën shtetërore të tundjes së brirëve
kundër njeriut të thjeshtë në botë.

USHTARI PUSHTUES

(Në zyrën e rekrutimit)

Dëgjo dhe hesht! — i tha shefi Xhon,
që mbante përpara një dosje të gjelbër, —
ushtarit i duhet një «Si urdhëron»,
asgjë më pak dhe asgjë më tepër.

Dhe trurin civil ti lere këtu,
se truri të nxit të sillesh kundër!
Dhe trurin ia futi në dosjen blu
dhe kafkën bosh ia mbushi me urdhër.

Pastaj ia hoqi pallton, xhaketën,
këpucët dhe rrobat civile të tjera.
Së bashku me rrobat ia zhveshi dhe veten,
si gjarpëri lëkurën e dimrit në ferra.

(Në takim me të dashurën)

E dashura erdhi të shohë ushtarin.
Ish ditë e vrejtur dhe binte shi.
Ajo mbi sup s'ia hodhi krahun
dhe u zbraps kur deshi ta puthë ai.

Ushtari e pyeti: — Ti ç'pate e dashur?
Pse rri kaq ftohtë dhe nuk më qesh?
Dhe vajza i tha: — S'vij dot më afër!
Kjo rrobë ushtari ka hyrë mes nesh.

Ushtari rrinte mbështetur te pushka
dhe vajza shikimin ia nguli në sy.

Dhe ushtari klithi i trembur: — Jo!
Ishte tmerruar nga pyetja e saj
— Por, sidoqoftë... — pëshpëriti ajo, —
sa poshtë ke rënë, qyqar!

Dhe vajza iku dhe ushtari mbeti,
si një kufomë e gjallë në këmbë.
Një top bubullime e zbrazti qielli
nga retë e varura përmbi kazermë.

HORATIT

Ti ke mijëra vjet, Horat
që hyn e del
nëpër tragjeditë e mëdha të botës
ku çdoherë e pësojnë Hamletët,
ti-as vritesh
dhe as plagosesh.

Dhe asnjë plagë të vogël
deri më sot, Horat,
nuk të ka hapur shpata.
Ndonjëherë, vallë,
kur ishe fëmijë,
a të ka gërvishur macja?

Siç duket, Horat,
ti paske lindur
vetëm për të shoqëruar fatet e Hamletëve
me një mirësi njerëzore të çiltër
në të gjitha skenat
me krime dhe tmerre.

Pas tyre shkon
u gjendesh pranë
në çastin e rënies përherë
vetëm për t'u thënë:
— Mirëvafsh
dhe engjëjt
të këndofshin në qiell!...

Vetëm kaq.
vetëm kaq, Horat?

KËNGË ME LAHUTË

Fort po shndrit e pak po nxe
kjo e vërteta përmbi dhé.
Në politikën e gjithë krajlive
filli i lëmshit është lidhë nyje:
janë bërë një shpata e kryqi,
janë bërë një prifti e polici,
janë bërë një tregu e miqësia,
janë bërë një gjoksi e shpina,
janë bërë një burgu e liria,
janë bërë një rrahja e puthja,
janë bërë një paqa e lufta,
janë bërë një stomaku e zemra.
Në zgavër të gjoksit ka hyrë dhelpira
që e lot bishtin te buzëqeshja...

Po ballë për ballë me dhelpërinë,
ne mos vdekshim me gungë në shpinë!
Ani se, ani se!

M A R S I

Se si është ky marsi!
Tani vrejtet e pas pak zë qesh,
të ngroh me frymë puhize të butë,
kur befaz kapelen ta flak në rrugë.
Pastaj pendohet ashtu, krejt më kot,
me erë tërbohët e s'përmbahet dot.
Por mos e shani: — Ky fare u çmend!
Se marsi është muaj adoleshent.
Në trup ai ndjen kaq gëzime e dhembje
nga farat e luleve e sythat e pemëve.

PRANVERA

Pranvera në mars s'ndjehet e qetë,
si vashëza, së cilës një djalë,
duke u skuqur pakëz dhe vetë,
paska guxuar t'i thotë... ca fjalë.

Pastaj në prill e shtron për tokë
qilimin e qëndisur nga dora e saj.
Me një fjongo reje të bardhë në kokë,
si nusja te dhëndrri futet në maj.

Dhe ecën e matur përpara të gjithëve,
si vajza çapkëne kur bëhet nënë.
Dy kokrra të freskëta, të kuqe qershie,
si vathë në vesh ajo ka vënë.

Ka varur te qafa, ka varur te gjoksi,
 jo ruaza, stolira dhe stema flori,
 po një çerdhe të vogël me këngë zogu
 dhe një rrëkezë të hollë pylli.

Në trup ka hedhur një vello rrezesh,
 që dielli tokës ia çon mesazh,
 (Një vello si kjo s'ka mundur të veshë
 as bija fodulle e Karlit të Madh.)

ZËRAT E HAPËSIRËS

Përgjegjësi burokrat i sektorit të blegtorisë
njerëzit e fushave pranverore
nga zyra i mori në telefon me radhë:

— Alo, shoku Spiro,
si jeni në drejtim të korrjes së njomishteve?

— Alo, shoku Çome,
si jeni në drejtim të mbarështrimit të viçave
në stallë?

Po njëri nga njerëzit e fushës në vend të
përgjigjes
la hapur telefonin për disa çaste në tavolinë,
që të hynin në kufje zërat e hapësirës:

— Muuuuuuuu!

— Beee, beeeee

— Ciu, ciu!

Atëherë përgjegjësi humbi në ekstazë.
Në fytyrë iu shkri pezhishka e lodhjes,
lapsi i ra nga dora në dysHEME PADASHUR
dhe i tha atij që ia punoi poshtë në bazë:
— Alo!

Të lutem, vëlla,
lere edhe pakëz telefonin hapur!

DIÇKA KA NDODHUR...

Sot kjo Lida gjashtëmbëdhjetëvjeçare
më dukej sikur nuk ishte në vete,
nëpër dhoma ecte sikur hidhte valle,
dhe krihej, hutohej, këndonte e qeshtë.

Herë vërshëllente si djalë çapkën,
përpara meje kalonte si era,
i flisja, hutohej, më thoshte «Ëhë»,
pa e pasur mendjen ku rrihte biseda.

Dhe tre fustanët që ka gjithsejt,
i ndërroi sa herë që dilte jashtë,
dhe ulej e rrinte, s'i rrihej në vend,
— Diçka ka ndodhur... — me vete thashë.

Pastaj nga jashtë se kush e thirri.
 Dhe ishte një ditë e bukur në maj.
 Pranvera që kishte pushtuar natyrën,
 po merrej siç dukej me zemrën e saj.

The gran e paka lehtë me bërtitje,
 që t'i dilte gjumi dhe ta shikonte:
 — Shibe, moj, se ç'mik
 na paska ardhur sot!

The granja u ngrit të mbyllte dritaren,
 që e kishte lënë pakëz ecur
 por s'ishte e ndjen shtjën e grackës
 që do ta hite pa pyllin e gjelbër.

MIKU

Natën kishte hyrë në dhomën time,
i trembur nga stuhia në mesin e verës.
Mbi raftin e librave ishte ulur e rrinte,
(sikur kish dalë nga vjershat e Mjedës).

Dhe gruan e preka lehtë me bërryl,
që t'i dilte gjumi dhe ta shikonte:
— Shihe, moj, se ç'mik
na paska ardhur sonte!

Dhe gruaja u ngrit të mbyllte dritaren,
që e kishim lënë pakëz çelur
por zogu e ndjeu shijen e grackës
që do ta linte pa pyllin e gjelbër.

INDIRNYRJE

Dhe nisi të vërtitet në kafazin-dhomë,
nga njëra qoshe tek tjetra... i gjori!
Për kujtim të Mjedës, — thashë, — a ta
lëshojmë?
Dritaren ia hapëm. Dhe doli.

NDËRHYRJE

Mësuesja shkruan një problem matematike në
dërrasë të zezë,
dhe u shpjegon nxënësve në klasë:
— Kosinus beta plus kosinus alfa...
Ndërkohë zogu antipedagogjik i pranverës
thërret e thërret: — Ciu, ciu,
pas xhamave përjashta.

Dhe nxënësit mundohen të mbajnë të qeshurën
nga ndërhyrjet e zogut
në mësimin e lëndës konkrete, të përpiktë.
Eh, ky zogu, pa dashur shkencën
e katandisi në lirikë.

Sepse dhe mësuesja,
e cila thirri tri herë «Kujdes!»
(s'mund t'i shmanget zogut njeriu!)
pa dashur shkroi në dërrasë të zezë:
— Kosinus beta plus kosinus... Ciu.

NË STACION

Në stacionin e trenit Lezhë-Tiranë,
në një stol të gjatë prej druri,
ish ulur një vajzë që e kishte kokën
të bukur si Dea e muzeumit.

Ne pritnim trenin dhe rrinim të heshtur
dhe vjedhurazi asaj ia hidhnim sytë,
nga sytë dhe buza gjysëm e qeshur
lëshonte mbi ne ca r Rathë gjithë dritë.

Aty pranë saj na rrinte një plak,
që llullën e shoi me gishtin e madh
dhe tymin e përzuri, si i zënë në faj,
që të mos e mbështilte kokën e saj.

DULQINJA

E kam krijuar me ëndrra
një vajzë të bukur iluzore,
por jo si ajo princesha
Dulqinja nga Toboza.

Është një vajzë e bukur,
është një vajzë-ëndërr,
një vegim që shfaqet
e shuhet duke qeshur.

Mos qoftë thënë që unë
ta mbaj gjithmonë në kokë!
Një vajzë si kjo, besoj,
jeton diku në botë.

Jeton ajo patjetër,
por s'di në cilin vend,
veç di që duhet gjetur,
diku në realitet.

Në rrugën plot me zëra
ja, ecin tokësoret vajza,
të ëndërruarës sime, njëra
oho,
sa shumë i ngjaka!

Por si ta gjej mënyrën
t'i them me çiltërsi:
Deri më sot kam pritur
të njoh një vajzë si ty...

Duhet bërë diçka e mirë
për këtë tokë, për këta njerëz,
që emri im një ditë
t'i shkojë asaj në vesh.

DËNIM I RREPTË

Më kujtohet mësuese Mira,
kur isha në klasë të tretë,
ne djemve kur bënim prapësira,
na jepte dënim të rreptë.

Nuk dua, të them, na rrihte
me thupër a me shuplakë,
po shokun e bangos na e hiqte,
na sillte një vajzë në bangë.

Edhe mbi mua pati rënë
dënimi i rreptë i saj:
— Të rrish me të! — më foli prerë
dhe s'pata se nga t'ia mbaj.

Por prapë s'më rrihej urtë,
qetësinë e thyeja shpesh,
dhe për inat të vajzës Teutë,
e ndava bangon me vijë në mes.

Si dy mbretëri fqinje armike
këtej unë-andej Teuta.
Dhe «agjentin» bërryl një herë
nga «kufiri» ia përzura.

Me inat edhe me vrull,
ajo e solli kokën prapa,
dhe ai gërsheti i saj pa turp,
kërceu, m'u hodh te qafa.

O, ai gërshet i mirë, i butë,
ish dhelkë, frikë edhe mesazh!
Sikur të ishte një hardhuckë
s'mora guximin ta përkas.

TROKITJA E SAJ

Në derën time trokitet me dorë,
se ende s'kam vënë zile me korrent,
ndaj, pa e hapur derën, unë e di,
që je ti që po troket.

Dhe nuk gaboj kur të them nga brenda
«Hyre!»,
duke të thirrë me emër,
se ti ke një trokitje të veçantë,
të lehtë, si në zemër...

DORËN KAM VËNË MBI SUPIN E SAJ

Dhe trupi dhe zemra kanë hyrë në maj,
ndaj dorën kam vënë mbi supin e saj,
dhe ecim të lumtur mes udhës së madhe,
ca koka kthehen të shohin këtë pamje.

Njëra nga kokat nuk di se ç'tha,
veç njëra qeshi me tallje: Ha-ha!
Dhe tjetra kollitet më kot: Khë, khë!
Tjetra hungëron më tutje: Ehë!

Tjetra këlthet: Pa shih, pa shih!
Tjetra e derdh çudinë me: Iih!
Tjetra e shfren bezdinë me: Uf!
Dhe kupa e durimit tek unë u mbush.

DORRIN KAM VËRE MBI SUPIN E SAJ

Dhe ndonëse ish ditë e bukur në maj,
në zemër më fryu marsi me erë,
dhe dora m'u drodh te supi i saj,
dhe vetja më tha: Mos e ler të bjerë!

NË TELEFON

Rrotulloj njëzetetë-njëzetekatrën,
ndërsa nga malli më dridhet dora,
por s'mund të lidhen, e dashur
centralisht dy zemrat tona.

Se nëpër tel ti s'mundesh të më sjellësh
një futje krahu në prag të mbrëmjes,
se nëpër tel nuk mundet të vijë
ai rrembi i flokut i rrëzuar në sy.

As dallga e gjoksit që ngrihet dhe ulet,
as fjalët që shuhën aty tek buzët,
as rrudhëza e hollë te shtegu i ballit,
si një shkrepimë e reve të mallit.

As metafora lirike e vetullës tënde,
që s'mund të shkruhet me alfabete,
as nazet e bukura të cilat përherë
kalasë vajzërore i japin vlerë.

Ti flet dhe flet... Dhe një pasthirmë
e dridhshme malli të del nga gjoksi,
më duket sikur në vend të kufjes,
unë mbaj në dorë një çerdhe zogu.

URIM

Nga dritarja e hapur
shoh rrugën që e ka mbuluar muzgu.
Një çift i porsamartuar, që e kam në lagje,
po kthehet nga zyra e Gjendjes Civile.

Ata duke ecur bëjnë humor
me ato pyetjet standarte që u ka bërë nëpunësi:
A e do shoqja Gëzime shokun Genci?
A e do shoku Genci shoqen Gëzime?

Dhe ai se ç'i thotë ca fjalë të tjera
dhe ajo me gjithë forcën e zemrës qesh
dhe një fëmijë
i zgjohet në sy...

Që sonte
ata janë më tepër se sa dy njerëz.
Dhe kurrë
mos qofshin dy!

V A J Z A T

Djemtë ngacmojnë vajzat që kalojnë në rrugë.
Dhe veç t'i shohësh të bukurat vajza!
Ato megjithëse ngacmimet e djemve i duan,
u japin përgjigje gjoja të ashpra.

Njëra ul kokën dhe ikën pa folur tutje,
tjetra kalon kryelartë si gjenerali në paradë,
tjetra kafshon nga brenda pakëz buzën,
tjetra si Amazonë përgjigjet flakë për flakë.

O ti, seriozitet i këndshëm vajëror,
përherë i rrezikuar si një portë kështjelle!
Të pata sulmuar një herë njëzet vjet më parë
dhe të pata thyer me një buzëqeshje.

Dhe kur ta preka me dorë belin fërgëllues,
dhe flokët e derdhur kur t'i kreha me gishta,
përpara teje më tepër se sa pushtues
i pushtuar isha.

ATY KU HYNI JU

Edhe një kokrrizë mikroskopike pluhuri,
shqisat tuaja e nuhasin
mbi rrobat dhe mobiljet në shtëpi.
Dhe ju vret po aq sa fjala e rëndë e burrit,
tymi i duhanit,
kur mendoni se ai del
nga mushkëritë e tij.

Në luftën që bëni kundër pluhurit të
përditshëm,
me fshesë dhe ujë
dhe me leckë të thatë,
ju jeni të rrepta si spartanet.
Ne burrave na vini një postbllok;
Ndalohet kalimi,
derisa të thahen pllakat!

Ndodh nganjëherë që ju, të dashura gra,
ngryseni nga qëndrimi ynë asnjans
përpara frontit të luftës suaj epiko-pastërtore.
Atëherë ne, si ushtarë të vonuar,
e zbrazim ndonjë armë, sa për të thënë,
duke shkundur qilimat në ballkone.

Të dashura gra!
Aty ku hyni ju,
pluhuri trembet dhe s'guxon të ulet,
aty është pasqyra, aty janë lulet,
aty është drita, aty janë puthjet,
nga të cilat lindin njerëz dhe burra.

SHOH KËTË GRUA

Shoh këtë grua që e ka goditur burri me
pëllëmbë.
Nuk dihet përse do të ketë qenë ajo «fajtores».
Veç dihet që e ka goditur te kjo faqe e shenjtë,
që është kryebukuria e fytyrës njerëzore.

Tek shenja në faqe ajo ka bërë pakëz makiazh,
e ka zbehur me pudër, që të kujtojnë të tjerët,
se është rrëzuar duke zbritur shkallët,
ose duke ecur në të errët.


O burrë-budalla që emrin dhe fytyrën nuk ta
njoh!
Veç për ty po e botoj këtë poezi në «Drita».
Se e di që një poezi si kjo,
është dënuar nga ti t'i mungojë poetika.

Mos kujto ti se je më i fortë se gruaja jote!
Dhe mos kërko prej saj bindje të verbër!
Se ajo është bijë e njeriut dhe banore e këtij
me dyqind e ca mijë motra dhe vëllezër.
qyteti

LEXUESIT

Shkrova këto poezi,
krijova ca zogj të bukur fjale,
të cilët i hodha në ajër për ty,
duke menduar se kështu
do t'i ndihmoja pranverës
dhe gëzimeve të ditës.

Po nuk të cicëruan në zemër
i hëngërt macja e kritikës!



PËRMBAJTJA

BIJTË E NJERËZVE TË MIRË

Po të isha vetëm	5
Mëngjesi	7
Në hotel	8
Shtatë ditë	9
Bari	10
Një natë	11
Orteku	14
«Syri magjik»	16
Një ditë	18
Një fëmije	19
Ndodhi e vogël	21
Telekronikat	24
Kronikë	25
Ngjarja e parë	27
Kur luanim	29
Në mobileri	31
Kënga	32
Motrës	34
Drini	36
Buzëqeshja	38
Gjyshi	39
Kur shikoja njerëzit në ditët e plazhit	43

POLITIKA E TUNDJES SË BRIRËVE

Në doganë	47
Në pallatin e progresit teknik	49
Bisedë me Merin	51
Një gazetari borgjez	53
Ushtari pushtues	55
Horatit	58
Këngë me lahutë	60

ZËRAT E HAPËSIRËS

Marsi	65
Pranvera	66
Zërat e hapësirës	68
Diçka ka ndodhur	70
Miku	72
Ndërhyrje	74

ATY KU HYNË JU

Në stacion	79
Dulqinja	80
Dënim i rreptë	83
Trokitja e saj	86
Dorën kam vënë mbi supin e saj	87
Në telefon	89
Urim	91
Vajzat	93
Aty ku hyni ju	95
Shoh këtë grua	97
Lexuesit	99

Gjetja, N

Çaste. Poezi, [Red., I. Thoma]. T.,
«Naim Frashëri» 1984,

104 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891-983-1

Gj. 58

Tirazhi 3000 kopje Format 70x100/32 Stash. 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re —
Tiranë, 1984